



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 33/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.01.2019 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së BOE “Avduli” shpk& “Bahas” shpk nga procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-88508-10-04-2018 me objekt: “*Prishje dhe pastrim objekti i ish frigoriferit Vlorë dhe sistemim i sheshit*”, me fond limit 15,000,116 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 12.11.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Inerti” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Ankimues: BOE “Avduli” shpk& “Bahas” shpk
Lagjia 10 Korriku, Rr “Perlat Rexhepi”, objekt 3 katësh,
nr.4, Kati.I, Vlorë

“Inerti” shpk
Lagjia “5 Maji”, Pallatet “Inerti” hyrja 2, kati.6 ngjitur me
Concord Center, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Bashkia Vlorë
Sheshi “4 Heronjtë”, Rruga:”Osman Haxhiu”

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për Miratimin e*

Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjeve, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, konstatoi se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.2. Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se këta të fundit kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit. nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

I.3. Operatorët ekonomikë kanë paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas kanë paraqitur ankesë, me të njëjtin objekt, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar;

I.4. Operatorët ekonomikë kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesave pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesave.

II

Rrethanat e çështjes

II.1 Në datën 04.10.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-88508-10-04-2018 me objekt: “*Prishje dhe pastrim objekti i ish frigoriferit Vlorë dhe sistemim i sheshit*”, me fond limit 15,000,116 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 12.11.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.

II.2. Në datën 12.11.2018 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit, objekt ankimi.

II.3. Në datën 26.11.2018 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës, nëpërmjet sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, ku rezulton si më poshtë vijon:

- B-93 pa ofertë I skualifikuar
- Avduli 9,417,933 I skualifikuar
- Inerti 14,877,880 I skualifikuar

II.4. Në datën 26.11.2018 BOE “Avduli” shpk & “Bahas” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Nuk disponon licencën III.2.B sipas përcaktimit ne dst.*

II.5. Në datën 03.12.2018, BOE “Avduli” shpk & “Bahas” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Referuar pretendimit të KVO se nuk disponojmë Licencën III.2.B sipas përcaktimit në DST është një pretendim i pabazuar në ligj pasi në DST autoriteti juaj ka kërkuar: Operatori ekonomik duhet të disponojë Licencë me kodin III.2.B për grumbullimin, transportimin e mbetjeve të dheut dhe mbetjeve inerte. Për të plotësuar këtë pikë subjekti jonë ka paraqitur në këtë procedurë prokurimi Licencën III.2B “Grumbullim, transportim ruajtje, riciklim, dhe asgjесim i mbetjeve urbane, kjo Licencë përfshin dhe mbetjet e dheut edhe mbetjet e inerteve, kështu që pretendimi juaj për skualifikim nuk qëndron. Licenca me Kod III.2B të cilën kemi paraqitur në këtë procedurë prokurimi është Licenca që keni kërkuar ju, në përshkrimin e veprimtarisë bëhet fjalë për mbetjet urbane pra në këtë përshkrim përfshihen edhe mbetjet e dheut dhe të inerteve që keni specifikuar në DST. Referuar edhe ligjit nr.10448 datë 14.07.2011 Për Lejet e Mjedisit si dhe VKM nr.538 datë 26.05.2009 për Licencat dhe Lejet rezulton se Licenca me Kod III.2.B “Grumbullim, transportim ruajtje, riciklim, dhe asgjесim i mbetjeve urbane” të cilën kemi paraqitur në këtë procedurë prokurimi e plotëson kriterin e kërkuar në DST e për pasojë nuk ka arsye për skualifikim pasi bëhet fjalë për të njëjtën licencë. Gjithashtu subjekti jonë ka paraqitur edhe një deklaratë nëpërmjet të cilës kemi deklaruar se Licenca që ne kemi paraqitur me kod III.2.B Grumbullim, transportim ruajtje, riciklim, dhe asgjесim i mbetjeve urbane”, Përfshin edhe mbetjet e dheut dhe të inerteve që keni specifikuar në DST. Kërkojmë kualifikimin e ofertës sonë.*

II.6. Nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë kthyer përgjigje lidhur me ankesën e paraqitur nga BOE Avduli” shpk & “Bahas” shpk.

II.7. Në datën 14.12.2018, pala ankimuese “BOE Avduli” shpk & “Bahas” shpk, ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.8. Në datën 26.11.2018 operatori ekonomik “Inerti” shpk është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi për arsyet si më poshtë vijon:

- *Vendi i ushtrimit të aktivitetit Shkoder (Shkolla industriale ”Arben Broci”), është hapur në datë 13.10.2017, ndërkohë vërtetim i lëshuar prej Bashkisë Shkodër përcakton që nuk është i rregjistruar, por jo që të ketë paguar detyrimet.*
- *Nuk ka paraqitur dokumentacion për 1 Ing.ndertimi (profili strukturist)*
- *Ing.Mjedisi Sadik Cama, bazuar në kontratën e lidhur paguhet me 35 000 lekë, por në listëpagesa rezulton se paguhet me 15,000 lekë dhe me kohe te pjeshme, si dhe nuk është i siguruar për gjithë periudhën e kërkuar.*
- *Ing.Topograf Dritan Prifti, bazuar në kontratën e lidhur paguhet me 35 000 lekë, por në listëpagesa rezulton se paguhet me 15,000 lekë dhe me kohe te pjeshme.*
- *Nuk disponon 6 drejtues automjetesh, por 5 pasi njërit prej tyre i ka përfunduar afati i lejes së drejtimit. Drejtuesit e mjeteve nuk janë të siguruar për gjithë periudhën e kërkuar.*
- *Kontrate qiraje midis shoqërisë “INERTI ” dhe shoqërisë “CACA IXHK” për mjetet me targa KR5189A dhe mjetin TR1231P. Mjeti TR1231P është në emër Bledar Xhavit Balla dhe është mbi 3,5 ton. Prokura e lëshuar nga Bledar Balla për Kujtim Caca dhe jo për shoqërinë “CACA IXHK”, nuk i jep tagrin ta japë me qira por vetëm për ta shitur. Mjeti KR5189A I përfundon siguracioni 12.11.2018 (ditën e hapjes së ofertave) dhe është mbi 3,5 ton.*
- *Kontrate qiraje midis shoqërisë “INERTI ” dhe shoqërisë “E&E NDËRTIM” për mjetet me targa. Ndryshimi i emrit të shoqërisë është bërë në datë 04.07.2017, ndërkohë që dokumentacioni për pagimin e taksave vjetore, kolaudim, siguracion janë kryer nën emrin e shoqërisë “PRENDI 02” edhe pse ka qenë me emër të ndryshuar në atë periudhë.*

II.9. Në datën 03.12.2018 operatori ekonomik “Inerti” shpk ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar vendimin e KVO-së për skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e mësipërme të prokurimit në mënyrë të përmbledhur me argumentat si më poshtë:

- *Lidhur me arsyen e parë të skualifikimit për 1 Ing ndërtimi profili strukturist, ju informojmë që shoqëria Inerti disponon të punësuar në pozicionin e inxhinierit strukturist Z. Vladimir Memlikaj, dokumentacioni për të cilin është dorëzuar së bashku me një vërtetim që faktin ekuivalentimin e diplomës së tij me titull Inxhinier Strukturist.*
- *Lidhur me pretendimin e dytë të AK ku mjeti me targa KR5189A i përfundon siguracioni 12.11.2018 ditën e hapjes së ofertave dhe është mbi 3.5 ton ju bëjme me dije që ky i fundit si pjesë të kapacitetit teknik ka kërkuar: Kamaioncinë kapaciteti mbajtës deri në 3.5 ton copë 2 në pronësi ose me qera. Për sa më sipër shoqëria Inerti shpk ka paraqitur dokumentacionin e 3 kamioncinave njëra ndër të cilat është dhe KR 5189A në pronësi të*

shoqërisë Caca IXHK ku dukshëm evidentohet përmbushja e këtij kriteri i cili kërkon vetëm dy të tilla. Mbi të gjitha deri në datën e zhvillimit të tenderit dokumentacioni është i vlefshëm. Pavlefshmëria e siguracionit mund të konstatohet vetëm pas datës 12. Nuk ka asnjë detyrim ligjor ose kushtëzim procedural i cili të detyrojë ofertuesin të ndër marrë veprime të parakohshme me dokumentacionet e mjeteve duke i shkaktuar kosto ekstra. Siguracioni i mjetit është i vlefshëm dhe mund të rinovohet ose në datën e skadencës së tij ose ditën e nesërme pasi kjo nuk çënon ekzistencën faktike të mjetit e cila është dhe qëllimi kryesor i AK.

- Gjithashtu lidhur me pretendimin e AK se Mjeti TR1231P është në emër Bledar Xhavit Balla dhe është mbi 3,5 ton. Prokura e lëshuar nga Bledar Balla për Kujtim Caca dhe jo për shoqërinë “CACA IXHK”, nuk i jep tagrin ta japë me qira por vetëm për ta shitur, sqarojmë se në prokurë është shtrirë kompetenca e Z.Caca që është edhe administrator i Caca IXHK dhe për veprime të tjera që nuk përmenden në prokurë që lidhen me tjetërsimin e mjetit gjithmonë në kontekstin e kalimit të pronësisë dhe disponimit dhe në gjykimin tonë duke qenë se edhe qiraja është një formë kalimi i përkohshëm disponimi i mjetit këto veprime konsiderohen të ligjshme. Gjithashtu vec të tjerash shoqëria Inerti ka paraqitur në tender dhe 7 mjete të tjera shtesë në numër më të madh për realizimin e një objekti që kërkon një kapacitet më të vogël teknik. Konkretisht mjetet me targa AA733NT, AA465PU, AA026KX, AA390MB, AA402RL, AA962MZ, AA490PI. Për sa më sipër nisur nga dokumentacioni i paraqitur nga ofertuesi kapaciteti teknik i kësaj shoqërie nuk mund të vihet në dyshim nga gjykime sipërfaqësore të bëra nga AK.
- Lidhur me arsyen e skualifikimit se “Kontrate qiraje midis shoqërisë “INERTI ” dhe shoqërisë “E&E NDËRTIM” për mjetet me targa. Ndryshimi i emrit të shoqërisë është bërë në datë 04.07.2017, ndërkohë që dokumentacioni për pagimin e taksave vjetore, kolaudim, siguracion janë kryer nën emrin e shoqërisë “PRENDI 02” edhe pse ka qenë me emër të ndryshuar në atë periudhë”, sqarojmë se fakti që ekziston një procedurë për ndryshimin e emrit dëshmon që kompania E&E ndërtim dhe Kompania Prendi 02 janë i njëjti subjekt. Nëse institucionet shtetërore private të cilat kanë në kompetence lëshimin e dokumentacioneve të cilat logjikisht janë bërë mbështetur në dokumentacionin e pronësisë ose në ekstrakt QKR kanë bërë një lapsus të tillë gramatikor kjo nuk çënon aspak në thelb vlefshmërinë e dokumentacionit që kërkohet pasi identifikimi i subjektit që ka në pronësi mjetin realizohet me anë të numrit unik NUIS i cili ndër të tjera ka si qëllim kryesor identifikimin si dhe është i pandryshueshëm pavarësisht ndryshimeve në emrin e subjektit. Gjithashtu vetë numri i shasisë mund të evidentojë qartazi mjetet. Në kushte të tilla dhe afati i dokumentave është brenda kërkesave të AK dhe mjeti disponohet faktikisht. Sic përmendëm edhe më sipër qëllimi kryesor është disponimi i mjetit për realizimin e punimeve dhe ky mjet brenda cdo vlefshmërie dhe procedure i është vënë në dispozicion shoqërisë inerti me anë të njëjtit kontrate qiraje. Gjithashtu shoqëria inerti ka paraqitur dokumentacion për 7 mjete të tjera shtesë vec kapacitetit të kërkuar nga AK.
- Lidhur me arsyen e skualifikimit Ing.Mjedisi Sadik Cama, bazuar në kontratën e lidhur paguhet me 35 000 lekë, por në listëpagesa rezulton se paguhet me 15,000 lekë dhe me kohe te pjeshme, si dhe nuk është i siguruar për gjithë periudhën e kërkuar.

- *Ing.Topograf Dritan Prifti, bazuar në kontratën e lidhur paguhet me 35 000 lekë, por në listëpagesa rezulton se paguhet me 15,000 lekë dhe me kohe te pjeshme, sqarojmë se AK nuk asnjë të drejtë të gjykojë mënyrën e pagesës së punonjësve pasi ajo mund të jetë e llogaritur në orë pune ditë pune ose në bazë të performacës. Ndër të tjera AK nuk ka kërkuar që stafi inxhinierik të jetë me kohë të plotë por ka kërkuar thjesht që : Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar. Duke qenë se stafi i paraqitur nga shoqëria Inerti shpk disponon një kontratë pune noteriale të vlefshme së bashku me dokumentacionin profesional figuron në listpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar atëherë ky kriter është përmbushur nga ana jonë plotësisht duke disponuar të gjithë stafin teknik të nevojshëm për realizimin e objektit.*

- *Lidhur me arsyen e skualifikimit se Vendi i ushtrimit të aktivitetit Shkoder (Shkolla industriale "Arben Broci"), është hapur në datë 13.10.2017, ndërkohë vërtetim i lëshuar prej Bashkisë Shkodër përcakton që nuk është i rregjistruar, por jo që të ketë paguar detyrimet", sqarojmë se në vërtetimin e lëshuar nga Bashkia Shkodër lënda citon Vërtetim shlyerje taksa dhe tarifa vendore dhe nënkupton dukshëm qëllimin dhe objektin e vërtetimit. Gjithashtu bashkëngjitur shoqëria Inerti ka depozituar në dokumentacionine ofertës edhe vërtetimin për pagesën e taksave dhe tarifavevendore e vitit 2018 ku formati i vërtetimit të bashkisë Shkodër është pothuajse i njëjtë. Pra vërtetimi i lëshuar nga Bashkia Shkodër është pikërisht për qëllim tenderi dhe për të evidentuar që shoqëria Inerti nuk ka detyrime ndaj kësaj bashkie. Nëse AK ka paqartësi lidhur me formën se si paraqitet ky vërtetim nga Bashkia Shkodër mund ti drejtohet kësaj të fundit me një shkresë zyrtare për kërkim informacioni.*

- *Për sa i përket arsyes së skualifikimit Nuk disponon 6 drejtues automjetesh, por 5 pasi njërit prej tyre i ka përfunduar afati i lejes së drejtimit. Drejtuesit e mjeteve nuk janë të siguruar për gjithë periudhën e kërkuar, sqarojmë se shoqëria Inerti ka paraqitur një numër më të madh se stafi i kërkuar , mbi të gjitha manovratorët e certifikuar për mjete ndërtimi kryejnë edhe detyrën e shoferit në shoqëri sipas dokumentacionit përkatës ndaj në kushte të tilla nuk mund të pretendohet nga AK mospërmbushja e këtij kriteri me arsyetimin se njërit prej shoferëve i ka përfunduar afati i lejes së drejtimit pasi shoqëria ka vënë në dispozicion më shumë shoferë se numri i kërkuar nga AK.
Sa më sipër kërkojmë kualifikimin e shoqërisë sonë.*

II.10. Nuk rezulton që autoriteti kontraktor të ketë kthyer përgjigje lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "Inerti" shpk.

II.11. Në datën 14.01.2019 pala ankimuese "Inerti" shpk., ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me të njëjtin objekt ankese dorëzuar pranë autoritetit kontraktor.

II.12. Nëpërmjet shkresës nr.11227 prot datë 31.12.2018 protokolluar me tonën me nr.1886/3 prot datë 14.01.2019 autoriteti kontraktor ka dorëzuar informacionin e kërkuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit objekt ankimi.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me pretendimin e BOE ankimues “Avduli” shpk&”Bahas” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se “*Nuk disponon licencen III.2.B sipas percaktimit ne dst*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Në shtojcën 12 “Kriteret e Vecanta të Kualifikimit” pika 2.3/6 “Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatori ekonomik duhet të disponojë Licencë me kodin III.2.B për grumbullimin, transportimin e mbetjeve të dheut dhe mbetjeve inerte.*

III.1.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se në përmbushje të kriterit sa më sipër BOE “Avduli” shpk&”Bahas” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Licencë kategoria III.2.B datë 11.01.2017 në emër të “Avduli” shpk me përshkrim veprimtarie “*Grumbullim, transport, ruajtje, riciklim dhe asgjësim i mbetjeve urbane.*
- Deklaratë me përmbajtje si vijon: Licenca me Kodin III.2.B “Grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim dhe asgjësim i mbetjeve urbane”, bazuar ne Vendimin e Keshillit të Ministrave perfshin edhe grumbullimin, transportimin e mbetjeve inerte.

III.1.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: “*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*” *Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionion dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*”

III.1.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.1.5. Në nenin 26, pika 8, gërma “a” e Vendimit nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore;

III.1.6. Në seksionin “Kategoria III.2. “Shërbime Ekspertizë ose profesionale lidhur me ndikimin në mjedis” , nëseksioni “Licencimi i kategorisë III.2.B”, pika 8 dhe 9 të Vendimit nr.538 datë 26.05.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar parashikohet se: “ Licencat për nënkategorinë III.2.B jepet për çdo vend ku kryhet veprimtaria. 9. Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.”

III.1.7. Referuar sa më sipër KPP gjykon se në kriterin e vecantë të kualifikimit autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të disponojnë Licencë me kodin III.2.B për grumbullimin, transportimin e mbetjeve të dheut dhe mbetjeve inerte. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga anëtari i bashkimit të operatorëve ekonomikë “Avduli” shpk rezulton se është dorëzuar Licencë kategoria III.2.B datë 11.01.2017 në emër të “Avduli” shpk me përshkrim veprimtarie “Grumbullim, transport, ruajtje, riciklim dhe asgjësim i mbetjeve urbane. KPP gjykon se Licenca që disponon operatori ekonomik Avduli shpk nuk është në përputhje me përcaktimet e autoritetit kontraktor në dokumentat e procedurës së prokurimit objekt ankimi. Gjithashtu referuar legjislacionit të sipërcituar konkretisht VKM nr.538 datë 26.05.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashëkta”, të ndryshuar parashikohet se “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme.” dhe jo vetëm grumbullim, transportim, ruajtje, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve urbane sic pretendon ankimuesi. Gjithashtu KPP gjykon se legjislacioni sektorial në fuqi ka një rregullim të ndryshëm për trajtimin e mbetjeve urbane dhe ato inerte. Akoma më tej KPP gjykon se nuk mjafton një deklaratë nga vetë subjekti për të krijuar bindjen se licenca me objektin e veprimtarisë së sipërcituar që disponon ankimuesi perfshin edhe objektin e kërkuar nga autoriteti kontraktor në kriterin e vecantë të kualifikimit, duke mos e provuar një fakt të tillë në asnjë moment. Gjithashtu ne kushtet e licencës të disponuar nga ankimuesi ky i fundit autorizohet/lejohet të transportjë vetëm llojin e mbetjeve letër dhe karton, qelq, mbetje të biodegradueshme nga kuzhinat dhe mensat, mbetje druri, plastikat, metale, mbetjet urbane të paspecifikuara, me kodet përkatëse. Referenca në katalogun e mbetjeve nga ana e ankimuesit duke pretenduar se në mbetjet urbane përfshihet dhe kategoria e mbetjeve me kod 20 02 02 Dhera dhe gurë nuk vërteton faktin se subjekti është i autorizuar në lejen që disponon për të bërë transportimin e këtyre lloj mbetjeve sa kohë që vetë leja që disponon specifikon qartazi se për cilat kategori mbetjesh është i autorizuar subjekti dhe në asnjë rast nuk rezulton të jetë i autorizuar për transportin e mbetjeve me kod 20.02.02 Dhera dhe Gurë.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Gjithashtu, Komisioni sqaron se nëse operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në lidhje me kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, parashikuar nga neni 63 pika 1/1 e LPP. Në nenin 63 pika 1/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar parashikohet se "*Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni*". Komisioni gjykon se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt ankimi.

Sa më sipër pretendimi i BOE "Avduli" shpk & "Bahas" shpk nuk qëndron.

III.2. Në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues "Inerti" shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se "*Kontrate qiraje midis shoqërisë "INERTI" dhe shoqërisë "CACA IXHK" për mjetet me targa KR5189A dhe mjetin TR1231P. Mjeti TR1231P është në emër Bledar Xhavit Balla dhe është mbi 3,5 ton. Prokura e lëshuar nga Bledar Balla për Kujtim Caca dhe jo për shoqërinë "CACA IXHK", nuk i jep tagrin ta japë me qira por vetëm për ta shitur. Mjeti KR5189A i përfundon siguracioni 12.11.2018 (ditën e hapjes së ofertave) dhe është mbi 3,5 ton*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Në shtojcën 12 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", pika 2.3/10 "Kapaciteti Teknik" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës:*

<i>Mjetet</i>	<i>Sasia</i>	<i>Gjendja</i>
<i>Auto vetëshkarkuese me kapacitet mbajtës dhe transportues mbi 30 ton</i>	<i>Copë 8</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Matrapik</i>	<i>Copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Kamionçinë kapaciteti mbajtës deri 3.5 ton</i>	<i>Copë 2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Eskavator me goma</i>	<i>Copë 2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Eskavator me zinxhir</i>	<i>Copë 2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Eskavator zinxhir + Pincë (gërshërë) për prerjen e kollonave dhe trarëve</i>	<i>Copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Fadromë me goma</i>	<i>Copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Autobot uji</i>	<i>Copë 2</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Depozite uji</i>	<i>Copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>
<i>Gjenerator</i>	<i>Copë 1</i>	<i>Në pronësi ose me qira</i>

- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), policen e sigurimit, aktin e kolaudit, taksat vjetore të mjetit, si dhe lejen e transportit nga bashkia për vetë ose të tjetër.
- Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë dhe kontrollojë në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës mjetet e pajisjet teknike të deklaruara sipas shtojcës Nr.10.

III.2.2. Në shtojcën modifikim mbi dokumentat e tenderit të publikuar nga autoriteti kontraktor përcaktohet si mëposhtë:

Nëdokumentatstandartetëtenderitpika 2.3 “Për Kapacitetin teknik”, pika 10 do të kryhet modifikimet simëposhtë:

Ishte: “Auto vetëshkarkuese me kapacitetmbajtësdhetransportuesmbi 30 tonCopë 8”
“Autobot uji Copë 2”

Bëhet: “Auto vetëshkarkuese me kapacitetmbajtësdhetransportuesmbi 18 ton Copë 8”
“Autobot uji Copë 2”

III.2.3. Referuar shkresës nr. 11227 prot datë 31.12.2018 protokolluar me tonën me nr.1886/3 prot datë 14.01.2019 të autoritetit kontraktor sqarohet se: *Dokumentacioni për 5 mjetet kamioncina të deklaruara në shtojcën 10 është i paplotë dhe jo në përputhje me përcaktimet në kriteret e kualifikimit në DST.*

III.2.4. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike konstatohet se në përmbushje të kriterit sa më sipër “Inerti” shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Deklaratë mbi disponimin e mjeteve ndër të tjera Kamioncine deri ne 3.5 mjeti me targa KR5189A, TR1231, A358BX, AA192MA, TR4942T
- Kontratë Qeraje Nr.1680 Rep, Nr.1096 Kol datë 29.05.2018 lidhur ndërmjet shoqëria Caca IXHK shpk dhe Shoqëria Inerti shpk me objekt Kamion me targa KR5189 A dhe Kamion me targa TR1231P shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, Certifikatë e Kontrollit Teknik të Mjetit Rrugor , Policë Sigurimi, Pagesa e takses vjetore, certifikatë për trasport mallrash brenda vendit dhe për llogari të vet.
- Kontratë Qeraje Nr.1801 Rep Nr.1151 Kol datë 05.06.2018 lidhur ndërmjet B.I dhe Shoqëria Inerti shpk me objekt kamion me targa AA358 BX dhe kamion me targa TR 9451M. Mjeti me targa AA358BX është i shoqëruar me leje qarkullimi, policë sigurimi, Certifikatë e kontrollit teknik , licencë për transport mallrash për të tretë.
- Kontratë Qeraje lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe Shpresa shpk me objekt kamioncinë me targa AA192MA. shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë pronësie, certifikatë e kontrollit teknik, policë sigurimi.
- Kontratë Qeraje lidhur ndërmjet N.K dhe Shoqëria Inerti shpk me objekt Kamioncine me targa TR4942 T shoqëruar me leje qarkullimi, certifikatë për kontrollin teknik të mjeteve rrugore certifikatë pronësie, foto. Police sigurimi.

III.2.5. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionion dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.2.6. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.2.7. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: .Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: c) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.2.8. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar elektronikisht, me qëllim përmbushjen e kriterit të sipërcituar lidhur me diponimin e mjeteve kamioncë copë 2 me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton, KPP vëren se, operatori ekonomik ankimues, ka paraqitur deklaratë mbi disponimin e makinerive nga ku rezulton se në cilësinë e kamioncinës janë deklaruar mjetet me targa KR5189A, TR1231, A358BX, AA192MA, TR4942T si dhe janë dorëzuar kontrata qeraje në objektin e të cilave përshkruhet kamioncinë shoqëruar me dokumentacionin përkatës. Komisioni konstaton se ankimuesi dëshmon se disponon kamioncina me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton. Lidhur me pretendimet e autoritetit kontraktor për mjetin me targa TR1231 disponuar nga shoqëria Inerti shpk me kontratë qeraje të lidhur rregullisht përpara noterit, KPP gjykon se pavarësisht se kontrata është lidhur mes shoqërisë Caca IXHK shpk dhe Inerti shpk dhe mjeti figuron në emër të Bledar Balla ankimuesi ka bashkëngjitur prokurën e cila autorizon administratorin dhe ortakun e vetëm të shoqërisë Caca IXHK, Kujtim Caca për të shitur këtë mjet por edhe të kryejë cdo veprim tjetër që nuk është thënë shprehimisht në këtë prokurë. Akoma më tej KPP verifikoi ekstraktin historik të regjistrimit tregëtar të shoqërisë Caca IXHK ku konstatoi se më datë 11.05.2012 shoqëria Caca IXHK ka shtuar adresën si vijon: Durrës Krujë Nikël Kamion tip Benz TR1231P në të cilin është bërë dhe regjistrimi i vendimit të asamblesë datë 08.05.2012 ku Kujtim Caca ortak i vetëm i shoqërisë ka vendosur të hap adresat sekondare si vijon: Kamion tip Benz TR1231P dhe Kamion tip Benz KR5189A. Në këto kushte KPP gjykon se është lehtëisht e provuar se mjeti është i disponueshëm nga shoqëria Caca IXHK shpk. Sa më sipër KPP gjykon se mjeti me targa TR1231P rezulton të jetë i regjistruar në regjistrin tregëtar të subjektit Caca IXHK dhe nuk ka asnjë dyshim që ky mjet të jetë disponuar përtej tagrave të dhena Kujtim Caca administratorit dhe ortakut të vetëm të shoqërisë Caca IXHK.

Gjithashtu edhe Mjeti me targa AA358BX është i shoqëruar me leje qarkullimi, policë sigurimi, Certifikatë e kontrollit teknik , licencë për transport mallrash për të tretë dhe është me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton.

Sqarojmë se, për autoritetin kontraktor është e domosdoshme që një operator ekonomik pjesëmarrës të përmbushë kriteret e përcaktuara nga ai në dokumentat e tenderit duke vërtetuar se disponon kapacitetet ekonomike, financiare, teknike profesionale me dokumentacionin e paraqitur, dhe nuk duhet të jetë qëllim në vetvete skualifikimi i tij duke gjykuar dhe shqyrtuar këtë dokumentacion në mënyrë të njëanshme e sipërfaqësore.

Sa më sipër analizuar, konstatojmë se, jemi në kushtet kur nga ana e operatorit ekonomik ankimues është plotësuar kërkesa e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor në lidhje me dokumentacionin për mjetet, pasi, në rastin konkret operatori ekonomik ankimues disponon atë në përputhje me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit.

KPP gjykon se ankimuesi ka paraqitur dokumentacion të vlefshëm dhe dëshmon kapacitetet e nevojshme për realizimin me sukses të kësaj kontrate.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik “Inerti” shpk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Inerti" shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se "*Vendi i ushtrimit të aktivitetit Shkoder (Shkolla industriale "Arben Broci")*", është hapur në datë 13.10.2017, ndërkohë vërtetim i lëshuar prej Bashkisë Shkodër përcakton që nuk është i rregjistruar, por jo që të ketë paguar detyrimet", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.3.1. Në shtojcën 12 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", pika 2.1 c "Kapaciteti ekonomik dhe financiar", të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Vërtetim se i ka shlyer taksat vendore për vitin 2017, në cdo vend të ushtrimit të aktivitetit.*

III.3.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatori ekonomik "Inerti" shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Vërtetim Nr.958 prot datë 13.11.2017 lëshuar nga Bashkia Shkodër me lëndë Vërtetim shlyrje taksa dhe tarifa vendore me përmbajtje si vijon: *Me anë të kësaj shkrese bazuar në kërkesën me numër praktike 20286 datë 13.11.2017 vërtetohet se subjekti Inerti shpk nuk është i regjistruar si tatim pagues në regjistrat e biznesit të Bashkisë Shkodër.*
- Vërtetim nr.562 prot datë 02.05.2018 lëshuar nga Bashkia Shkodër me lëndë Vërtetim shlyerje taksa dhe tarifa vendore me përmbajtje si vijon: *Me anë të kësaj shkrese vërtetohet se subjekti Inerti shpk rezulton jashtë teritorit të Bashkisë Shkodër prandaj detyrimet ndaj taksave dhe tarifave vendore kundrejt Bashkisë Shkodër janë zero për vitin 2018.*

III.3.3. Neni 12 "Rregjistrimi dhe Liçensimi" i Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar parashikon se: Taksapaguesit, subjekte të këtij ligji, regjistrohen, për qëllime fiskale, pranë Qendrës Kombëtare të regjistrimit, në përputhje me ligjin e posaçëm. Ndryshimet në vendin e ushtrimit të veprimtarisë dhe të të dhënave të tjera tregtare kryhen sipas dispozitave të ligjit për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

III.3.4. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*" Aftësia teknike: *operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.*"

III.3.5. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e*

përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik, referuar dokumentacionit sa më sipër, si dhe verifikimit të të dhënave të subjektit në Ektraktin Historik të QKR konstaton se zyra qendrore e shoqërisë “Inerti” shpk është në Gramsh ndërsa ka të regjistruar si vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit Shkodër, Tiranë, Korçë, Vlorë. Gjithashtu KPP vëren se adresa e shoqërisë “Inerti” për Shkodrën është regjistruar më datë 13.10.2017. Komisioni gjykon se në kushtet kur vetë autoriteti vendor Bashkia Shkodër ka lëshuar një vërtetim me lëndë vërtetim për shlyerje taksa dhe tarifa vendore për subjektin Inerti shpk dhe konfirmim faktin se Inerti shpk nuk është i regjistruar si tatim pagues në regjistrat e biznesit të Bashkisë Shkodër do të thotë që ky subjekt nuk ka asnjë detyrim për të shlyer sa kohë që nuk ushtron aktivitet në këtë Bashki. KPP gjykon se autoriteti kontraktor nëse do të kishte dyshime mbi dokumentin vërtetim lëshuar nga Bashkia Shkodër mund të kishte kryer të gjitha verifikimet e nevojshme duke kërkuar sqarimet e nevojshme nga autoriteti kompetent i cili në rastin konkret me dokumentin që ka lëshuar ka vërtetuar faktin se subjekti Inerti shpk nuk ka detyrime ndaj kësaj bashkie për sa kohë që nuk është i regjistruar në regjistrat e saj dhe rrjedhimisht nuk ka detyrime në këtë njësi vendore për vitin 2017.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ”Inerti” shpk qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ”Inerti” shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se ”*Ing.Mjedisi Sadik Cama, bazuar në kontratën e lidhur paguhet me 35 000 lekë, por në listëpagesa rezulton se paguhet me 15,000 lekë dhe me kohe te pjeshme, si dhe nuk është i siguarur për gjithë periudhën e kërkuar, Ing.Topograf Dritan Prifti, bazuar në kontratën e lidhur paguhet me 35 000 lekë, por në listëpagesa rezulton se paguhet me 15,000 lekë dhe me kohe te pjeshme*”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.4.1. Në shtojcën 12 ”Kriteret e Vecanta të Kualifikimit”, pika 2.3.3, 2.3.4 ”Kapaciteti Teknik” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

1. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar, si më poshtë

- ing.ndërtimi 1

- ing.mjedisi 1

- ing.ndertimi (profili strukturist) 1

- ing.topograf/gjeodet/markshajder 1

2. Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) punonjës të siguarur për periudhën Shkurt – Gusht 2018 Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore/ose Tatimore

Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për të gjithë periudhën e kërkuar më sipër.

III.4.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më lart operatori ekonomik "Inerti" shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontrata Pune , CV, Libreza Pune për Ing.Mjedisi dhe Ing.Topograf
- Listpagesat e shoqërisë Inerti shpk për periudhën Janar 2018-Nëntor 2018

III.4.3. Në nenin 46, pika 1, gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese."* *Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës."*

III.4.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin Publik" i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.4.5. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.4.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Inerti shpk rezulton se është dorëzuar dokumentacioni i kërkuar në kriterin e kualifikimit për Inxhinierin e Mjedisit dhe Inxhinierin Topograf . Konkretisht është dorëzuar për të dy inxhinierat kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës. Nga verifikimi i listpagesave të shoqërisë Inerti shpk rezulton se Inxhinieri i Mjedisit S.C ndryshe nga sa pohon autoriteti kontraktor rezulton në listpagesat e shoqërisë për të gjithë periudhën e kërkuar Shkurt-Gusht 2018.

Lidhur me pretendimin e autoritetit kontraktor se *bazuar në kontratën e lidhur paguhet me 35 000 lekë, por në listëpagesa rezulton se paguhet me 15,000 lekë dhe me kohe te pjeshme*, për të dy Inxhinierat, KPP gjykon se e rëndësishme për autoritetin kontraktor është disponimi i stafit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesmarrës dhe dorëzimi i dokumentacionit që provon këtë fakt sikundër është paraqitur në rastin konkret. Fakti i mospërputhjes së pagës të shprehur në kontratën e punës dhe asaj që rezulton në listpagesë dhe paraqitja e saj si arsye skualifikimi tejkalon qëllimin e vendosjes së kriterit dhe nuk është në diskrecion të autoritetit kontraktor por të orageneve të tjera kompetente.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë

të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik "Inerti" shpk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Inerti" shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se "*Nuk ka paraqitur dokumentacion për 1 Ing.ndertimi (profili strukturist)*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.5.1. Në shtojcën 12 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", pika 2.3.3, 2.3.4 "Kapaciteti Teknik" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë, CV, librezat e punës si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë për periudhën e kërkuar, si më poshtë

- *ing.ndërtimi 1*

- *ing.mjedisi 1*

- *ing.ndertimi (profili strukturist) 1*

- *ing.topograf/gjeodet/markshajder 1*

Operatori ekonomik duhet të disponojë një numër mesatar prej jo më pak se 115 (njëqind e pesëmbëdhjetë) punonjës të siguruar për periudhën Shkurt – Gusht 2018 Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore/ose Tatimore Listpagesat sipas formës që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për të gjithë periudhën e kërkuar më sipër.

III.5.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se operatori ekonomik "Inerti" shpk në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Pune nr.3154 rep, nr.2304 kol lidhur ndërmjet shoqëria Inerti shpk dhe V.M me detyrë Drejtues Teknik Ing. Indërtimi, shoqëruar me referencë pune, Diplomë me titull Inxhinier për Ndërtime Civile Industriale, CV, Librezë Pune, certifikatë trajnimi për përgjegjës trajnimi për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë, Vërtetim nr.30/8 prot

datë 30.08.2018 lëshuar nga Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit me përmbajtje si vijon: Vërtetohet se V.M ka përfunduar Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit në degën e Inxhinieri Ndërtimi-Inxhinier Ndërtimi për ndërtime civile industriale. Titulli i diplomës Inxhinier ndërtimi për ndërtime civile industriale e Z.V.M është ekuivalente me titullin Inxhinier Strukturist.

III.5.3. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.5.4. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.5.5. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *.Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit*

III.5.6. KPP gjykon se arsya e skualifikimit se operatori nuk ka dorëzuar dokumentacion për Inxhinier me profil strukturist në rastin konkret nuk është e bazuar. Operatori ekonomik ankimues përvec dokumentacionit të kërkuar nga autoriteti kontraktor diplomë, cv, librezë pune etj ka dorëzuar një vërtetim lëshuar nga autoriteti kompetent Fakulteti i Inxhinierisë së ndërtimit i cili konfirmon faktin se titulli që zotëron V.M është ekuivalent me titullin Inxhinier Strukturist të kërkuar nga autoriteti kontraktor. KPP gjykon se e rëndësishme për autoritetin kontraktor është disponimi i stafit nga ana e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës dhe dorëzimi i dokumentacionit që provon këtë fakt sikundër është praqitur në rastin konkret.

Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të

përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik "Inerti" shpk qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Inerti" shpk për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se "*Nuk disponon 6 drejtues automjetesh, por 5 pasi njërit prej tyre i ka përfunduar afati i lejes së drejtimit. Drejtuesit e mjeteve nuk janë të siguruar për gjithë periudhën e kërkuar*", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.6.1. Në shtojcën 12 "Kriteret e Vecanta të Kualifikimit", pika 7 "Kapaciteti Teknik" të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

- *Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 6 (gjashtë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda te pajisur me leje/dëshmi perkatëse, si dhe 6 (gjashtë) drejtues automjetesh. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmite perkatëse te drejtimit, lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë.*

III.6.2. Në shtojcën modifikim mbi dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

Në dokumentat standarte të tenderit pika 2.3 "Për Kapacitetin teknik", pika 7 do të kryhet modifikimet si më poshtë:

Ishte: "*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 6 (gjashtë) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda te pajisur me leje/dëshmi perkatëse, si dhe 6 (gjashtë) drejtues automjetesh. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmite përkatëse te drejtimit, lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë*".

Bëhet: "*Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar minimalisht 4 (katër) punonjës manovratorë të mjeteve të rënda te pajisur me leje/dëshmi perkatëse, si dhe 6 (gjashtë) drejtues automjetesh. Për këto punonjës duhet të paraqitet kontrata e punës dhe dëshmite përkatëse te drejtimit, lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë*".

III.6.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se në përmbushje të kriterit sa më sipër operatorit ekonomik "Inerti" shpk ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kontratë Pune datë 26.03.2018 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe I.D me detyrë shofer/manovrator shoqëruar me dëshmi aftësie profesionale.
- Kontratë Pune datë 15.01.2018 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe F.B me detyrë shofer/manovrator shoqëruar me leje manovrimi/dëshmi aftësie profesionale.
- Kontratë Pune datë 26.03.2018 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe K.H me detyrë shofer/manovrator shoqëruar me dëshmi aftësie profesionale.

- Kontratë Pune datë 08.02.2018 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe R.A me detyrë shofer/manovrator shoqëruar me leje drejtimi dhe certifikatë aftësie profesionale .
- Kontratë Pune datë 31.05.2018 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe K.T me detyrë Manovrator shoqëruar me dëshmi aftësie profesionale
- Kontratë Pune datë 23.08.2018 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe A.D me detyrë shofer/manovrator shoqëruar me dëshmi aftësie profesionale dhe leje drejtimi
- Kontratë Pune datë 23.08.2018 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe J.R me detyrë manovrator shoqëruar me dëshmi aftësie profesionale dhe leje drejtimi.
- Kontratë Pune datë 03.01.2016 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe L.M me detyrë shofer/manovrator shoqëruar me dëshmi aftësie profesionale dhe leje drejtimi.
- Kontratë Pune datë 03.01.2016 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe Xh.B me detyrë shofer/manovrator shoqëruar me dëshmi aftësie profesionale dhe leje drejtimi.
- Kontratë Pune datë 24.08.2018 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe L.B me detyrë shofer/manovrator shoqëruar me dëshmi aftësie profesionale lëshuar nga DPSHTRR
- Kontratë Pune datë 03.01.2016 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe I.M me detyrë shofer, me leje drejtimi.
- Kontratë Pune datë 01.04.2015 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe A.A me detyrë shofer, dëshmi aftësie.
- Kontratë Pune datë 06.04.2018 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe K.K me detyrë shofer, leje drejtimi.
- Kontratë Pune datë 01.07.2016 lidhur ndërmjet Inerti shpk dhe H.M me detyrë shofer shoqëruar me leje drejtimi.

III.6.4. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.” Aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.6.5. Neni 53 pika 3 e Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik” i ndryshuar parashikohet shprehimisht se: *Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 54 të këtij ligji.*

III.6.6. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:b)dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;*

III.6.7. Referuar sa më sipër KPP gjykon se operatori ekonomik Inerti shpk ka dorëzuar dokumentacion lidhur me manovratorët dhe shoferët më shumë se numri i kërkuar në kriterin e kualifikimit. KPP gjykon se ankimuesi ka provuar se disponon në stafin e tij shoferët dhe manovratorët e nevojshëm për këtë kontratë. Fakti që operatori ekonomik ka paraqitur dokumentacion për më shumë manovratorë se sa kërkohen nga autoriteti kontraktor në kriterin e kualifikimit do të thotë që plotësohet më së miri dhe numri i shoferve të automjeteve të cilët për më tepër kanë të cilësuar në kontratë edhe detyrën e shoferit dhe atë të manovratorit. KPP konstaton se për manovratorët dhe shoferët ankimuesi ka paraqitur dëshmi aftësie profesionale dhe leje drejtimi të lëshuar nga organet kompetente. Gjithashtu KPP gjykon se pretendimi i autoritetit kontraktor se punonjësit sa më sipër nuk janë në listpagesa për të gjithë periudhën e kërkuar, nuk është i bazuar dhe është një vlerësim përtej kërkesave të kriterit i cili në asnjë rast nuk ka kërkuar që këta punonjës të jenë në listagesa për të gjithë periudhën Shkurt-Gusht 2018 por ka kërkuar që të figurojnë në listpagesa që do të thotë të figurojnë që nga momenti i kontraktimit të tyre detyrim i cili është përmbushur nga operatori ekonomik ankimues pasi të gjithë punonjësit e sipërcituar rezultojnë në listpagesat e shoqërisë.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues ”Inerti”shpk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e ankimuesit për kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij me arsyetimin se ”Kontrate qiraje midis shoqërisë “INERTI ” dhe shoqërisë “E&E NDËRTIM” për mjetet me targa. Ndryshimi i emrit të shoqërisë është bërë në datë 04.07.2017, ndërkohë që dokumentacioni për pagimin e taksave vjetore, kolaudim, siguracion janë kryer nën emrin e shoqërisë “PRENDI 02” edhe pse ka qenë me emër të ndryshuar në atë periudhë”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.7.1. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik Inerti shpk rezulton se në përmbushje të kriterit lidhur me mjetet e kërkuara në procedurën e prokurimit objekt ankimi është dorëzuar ndër të tjera një kontratë qeraje me nr.4154 rep nr.2121 kol datë 11.09.2017 lidhur ndërmjet Shoqëria E&E NDËRTIM shpk dhe shoqëria Inerti shpk me objekt mjetet me targa AA465 PU,AAR996, ADR746, AA591FC, AA245EL (kamion nga 3.5-7.5 ton), AAR991 shoqëruar me dokumentacionin përkatës për regjistrimin e mjetit leje qarkullimi , policë sigurimi, certifikatë e kontrollit teknik të mjetit rrugor,licencë për transport mallrash për të tretë dhe me qera brenda vendit datë 19.05.2016 në emër të Prendi 02 shpk me NUIS K38707085U. Gjithashtu bashkëngjitur këtij dokumentacioni gjendet edhe certifikata e regjistrimit të subjektit E&E NDËRTIM shpk me NUIS K 38707085U dhe Vendim Nr.1 datë 04.07.2017 i asamblesë së ortakëve të shoqërisë Prendi 02 shpk në të cilin është vendosur dhe miratuar ndryshimi i emrit të shoqërisë Prendi 02 shpk në E&E NDËRTIM shpk.

III.7.2. Sa më sipër KPP gjykon se arsyeja e skualifikimit dhënë shoqërisë Inerti shpk se *Ndryshimi i emrit të shoqërisë është bërë në datë 04.07.2017, ndërkohë që dokumentacioni për pagimin e taksave vjetore, kolaudim, siguracion janë kryer nën emrin e shoqërisë “PRENDI 02” edhe pse ka qenë me emër të ndryshuar në atë periudhë,* nuk është e bazuar sa kohë që vërtetohet

lehtësisisht se bëhet fjalë për të njëjtën shoqëri e cila me vendim asambleje ka vendosur vetem ndryshimin e emrit dhe duke mbajtur të pandyshuar numrin e identifikimit NUIS të regjistrimit të subjektit. KPP gjykon se në rastin konkret nuk asnjë dyshim dhe asnjë konfuzion lidhur me disponimin e mjeteve nga ana e operatorit Inerti shpk i cili vërteton me doskumentacion provues se ka lidhur kontratë qeraje të rregullt para noterit me subjektin E&E NDËRTIM shpk i cili është i njëjtë me subjektin që mban emrin në dokumentacionin e regjistrimit të mjetit.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues “Inerti” shpk qëndron.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Inerti” shpk për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*” me Nr. REF-88508-10-04-2018 me objekt: “*Prishje dhe pastrim objekti i ish frigoriferit Vlorë dhe sistemim i sheshit*”, me fond limit 15,000,116 lekë pa tvsh, e zhvilluar në datën 12.11.2018 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Vlorë.
2. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga BOE “Avduli” shpk “Bahas” shpk në procedurën e prokurimit të sipërcituar.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomik “Inerti” shpk duke e kualifikuar atë.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Inerti” shpk.
6. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1886 Protokoli; Datë 14.12.2018

Nr.1931 Protokoli; Datë 20.12.2018

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Wilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha